

## **1. Njesia e Inteligjences Financiare. (NIF-i Shqipëtar)**

### **1.1 Statusi i NIF**

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave ushtron funksionet e Autoritetit Përgjegjës, sipas ligjit Nr. 8610, 17.05.2000, “Per parandalimin e pastrimit te parave”, ndryshuar me ligjin nr. 9084, date 19.06.2003, “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 8610, date 17.05.2000 Per parandalimin e pastrimit te parave”, si një institucion qendror në varësi të Ministrit të Financave. Kjo drejtori, brenda fushës së veprimtarisë së saj, ka të drejtë të vendosë vetë për mënyrën e ndjekjes dhe të zgjidhjes së çështjeve të trajtuara për pastrimin e mundshëm të parave.

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave shërben si njësi e specializuar financiare për parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Ajo funksionon si qendër kombëtare e ngarkuar me mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen e të dhënave për veprimtaritë e mundshme të pastrimit të parave.

Marrëdhëniet e punës së kësaj Drejtorie rregullohen me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”

Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. NIF shqiptar është ndertuar sipas modelit administrativ të përcaktuar nga Egmont Group

### ***Misioni***

Misioni i NIF-t është : « Te punojme me partneret tane kombetare dhe nderkombetare per te zbuluar dhe goditur fenomenet e pastrimit te parave dhe financimit te terrorizmit”


### **1.2 Struktura dhe Burimet Njerezore**

Struktura dhe organika e Drejtorise se Pergjithshme te Parandalimit te Pastrimit te parave eshte miratuar me urdherin e Kryeministrit nr.10, date 24.01.2006 “Per miratimin e struktures dhe organikes se Drejtorise se Pergjithshme te Parandalimit te Pastrimit te Parave”

Ne baze te ketij vendimi, numri i punonjesve ne DPPPP u rrit nga 10 ne 22 punonjes. Si specialistet e rinj ashtu edhe specialistet me eksperience me te madhe pune ne DPPPP kane nje munges profesionalizmi çfare ka ndikuar edhe ne rezultatet jo te mira te punes per vitin 2006. Keta specialiste kane nevojë per trajnime profesionale, per shkak te natyres se vecante te punes qe ata duhet te kryejne ne DPPPP. Megjithë trainimet e kryera nga FINCEN (sherbimi homolog Amerikan), FMN dhe OSBE, perseri stafi vuan nga mungesa e profesionalizmit.

Struktura e DPPPP-se eshte prezantuar ne skemen e meposhtme. Siç duket edhe nga kjo skeme, ne strukturen e DPPPP-se ka tete drejtues (shef sektori dhe Drejtore),

ndersa çdo sektor i analizës dhe inspektimit ka vetëm dy specialiste, çfarë e ka bërë mjaft jo produktive këtë strukturë.



### 1.3 Buxheti i Drejtorisë për vitin 2006

Fondi i akorduar nga Buxheti i Shtetit të vitit 2006 për Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave kanë qenë si më poshtë:

	<b>ne 000/leke</b>
Pagat(600)	22,000 leke
Sigurime shoqërore(601)	6,000 leke
Shpenzime korrente(602)	12,000 leke
Shpenzime për investime(231)	15,000 leke
<b>TOTALI:</b>	<b>55.000 leke</b>

### Realizimi i buxhetit për vitin 2006

Realizimi i Buxhetit të Vitit 2006 për periudhën 12- mujore paraqitet si më poshtë:

Llog	Emertimi i shpenzimeve	5- mujori i vitit 2005			12-mujori i vitit 2006		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
600	Pagat	4000	3004	75.1	21980	14352	65.3
601	Sigurimet Shoqërore	1500	728	48.5	6000	3242	54.0
602	Shpenzime Korrente	3000	1574	52.5	12000	5247	43.7

<b>604</b>	Ndihme per fatkeqesi				20	20	100
<b>231</b>	Investime	5214	5214	100	15000	1203	8.02
	<b>SHUMA:</b>	<b>13714</b>	<b>10520</b>	<b>76.7</b>	<b>55000</b>	<b>24064</b>	<b>43.8</b>

Nga tabela e mesiperme shohim se nuk kemi tejkalime te zerave te buxhetit. Fondi i Pagave eshte realizuar ne masen 65.3 % pasi numri i punonjesve per strukturen e re te miratuar ne shkurt 2006, ishte parashikuar te ishte 31 por u miratuan vetem 22. Fondi i sigurimeve shoqerore eshte realizuar ne masen 54.0% edhe kjo per arsyet e siperpermendura. Per periudhen 12- mujore realizimi i shpenzimeve deri kur fondi i investimeve ka qene 15,000,000.00 leke ishte ne masen 8.02%

Ne Dhjetor 2006 me Akt Normativ te Ministrise se Financave dhe ne zbatim te VKM-se nr. 814 dt. 15.12.2006 eshte pakesuar fondi i DPPPP-se si me poshte:

Ne 000/ leke

Artikullin 600 - 7.000  
 Artikullin 601 - 2.600  
 Artikullin 602 - 6.400

**TOTALI :** - 16.000

Pas ketyre pakesimeve, realizimi i buxhetit te shtetit te vitit 2006 rezulton si me poshte:

ne 000/leke

LLog	Emertimi i shpenzimeve	12- mujori 2006		
		Plan	Fakt	%
<b>600</b>	Pagat	14.980	14.352	95.8
<b>601</b>	Sigurimet Shoqerore	3.400	3.242	95.3
<b>602</b>	Shpenzimet Korente	5.600	5.247	93.6
<b>604</b>	Ndihme per fatkeqesi	20	20	100
<b>231</b>	Investime	3.000	1203	40.1
	<b>SHUMA:</b>	<b>27.000</b>	<b>24.064</b>	<b>89.1</b>

Nga tabela shohim se fondi i pagave eshte realizuar ne masen 95.8%, fondi i sigurimeve shoqerore ne masen 95.3% , investimet ne masen 40.1% dhe shpenzimet korente ne masen 93.6%.

### *Financime nga donatoret e huaj*

Gjate periudhes 12-mujore te vitit 2006 ne Drejtorine e Pergjithshme te Parandalimit te Pastrimit te Parave eshte perfituar:

Granti nga zyra teknike e Departamentit Amerikan te Thesarit per antene satelitore (IT) per rivendosjen e kontakteve me grupin EGMONT ne shumen **7.280 USD**

Trajnim i 8-te punonjesve te DPPPP ne muajn Qershor te vitit 2006 ne shumen **17.000 USD** nga FINCEN - The American Financial Crimes Enforcement Network, ne Amerike.

#### **1.4 Puna ne Zyren e Marredhenieve me Publikun gjate vitit 2006**

Qe ne vitin 2005 DPPPP ka filluar nje fushate ndergjegjesimi te publikut, per te bere te mundur njohjen e publikut te gjere dhe te subjekteve te ligjit ne vecanti, me dy fenomenet qe analizohen dhe mundohet te parandalohen nga specialistet e saj. Ne vecanti, mesazhi ka synuar te ndergjegjesoje publikun mbi denimet penale dhe masat administrative per mosdeklarimin e parase CASH ne pikat e kalimit te kufirit dhe efektet negative qe burojne nga ekzistenca e tregut informal valutor. Kjo erdhi si nevoje e paevitueshme pas hartimit te draftit te Programit Kombetar per kontrollin e levizjes se monedhes cash ne Republiken e Shqiperise nga Keshilli Kombetar i Bashkerendimit te Luftes Kunder Pastrimit te Parave.

Gjate vitit 2006 fushata sensibilizimi dhe ndergjegjesimi te pergjithshem, trajnime dhe seminare jane organizuar per subjektet e ligjit, ato ekzistuese, apo edhe ato te cilat pritet te perfshihen ne ligjin e ri qe po hartohet me ndihmesen e specialisteve te te gjitha institucioneve partnere, nen kujdesin e vecante te Fondit Monetar Nderkombetar.

Konkretisht jane organizuar 3 seminare:

1. Seminar mbi ndergjegjesimin e bankave te nivelit te dyte per rendesine e raportimit te transaksioneve te vlerave ( RTV, transaksione te kryera mbi vleren e lejuar ne ligj, 20 milion leke) dhe te transaksioneve te dyshimta (RAD, transaksione te cilat edhe pse mund te mos e tejkalojne vleren limit te lejueshme, shfaqin anomali te ndryshme, krijojne dyshime per prejardhjen, destinacionin, etj te fondit objekt te transaksionit). Ky seminar u organizua ne fillim te Shtatorit 2006 per punonjesit e bankes EMPORIKI, ne kuader te projektit per implementimin e programit te ri te raportimit elektronik te RTV nga bankat e nivelit te dyte tek Autoriteti Pergjegjes (DPPPP). Diskutimet u mbajten nga Drejtori i Pergjithshem i DPPPP dhe nga specialistet e analizes, te cilet ofruan nje demonstrim praktik te perpilimit te formulareve te raportimit elektronik.
2. Seminar trajnimi mbi investigimin e krimeve financiare, financimin e terrorizmit dhe pastrimin e parave te organizuar nga United States Defence Departement of International Legal Studies, ne bashkepunim me PAMECA, ICITAP dhe OPDAT. Seminari u organizua ne fund te Shtatorit 2006 dhe ne te moren pjese specialiste te DPPPP dhe te institucioneve te tjera partnere qe punojne se bashku ne luften kunder financimit te terrorizmit dhe pastrimit te parave.
3. Seminar mbi prezantimin e variantit perfundimtar te programit te raportimit elektronik(AML) si dhe mbi ndergjegjesimin e subjekteve raportuese, jo vetem banka, mbi rendesine e raportimit prane DPPPP ne forme elektronike. Ne kete seminar te organizuar nga DPPPP me financim dhe asistencen te OSBE-se, eshte percjelle pervoja e mire e pese bankave te nivelit te dyte, qe

tashme kane filluar raportimin elektronik dhe per te cilat jane organizuar trajnime te vecanta, per sa i perket eksperteve IT te ketyre bankave. Ne seminar u mblodhen per te diskutuar se bashku me specialistet e DPPPP dhe perfaqesuesit te Kompanise INTECH+, qe eshte edhe hartuesja dhe zbatuesja e programit AML, specialiste te Drejtorise se Pergjithshme te Doganave, Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve, ZQRPP, AMF, Dhomes se Notereve, Dhomes se Avokateve, Shoqates se Bankiereve Shqiptare, etj, ne lidhje me menyren e raportimit qe mendohet te parashikohet ne ligjin e ri mbi Pastrimin e Parave. U diskutua gjithashtu menyra me e mire dhe efikase e bashkepunimit nderinstitucional, qe pasqyrohet fare mire ne menyren e raportimit te ketyre subjekteve prane DPPPP-se, si Autoriteti Pergjegjes per mbledhjen, analizimin dhe shperndarjen e informacionit financiar ne lidhje me aktivitetet e dyshuara si pastrim parash apo financime potenciale te aktiviteteteve terroriste. Gjate seminarit u demonstrua nje demo e variantit perfundimtar te “AML”, e cila u pasua nga diskutimet, jo vetem te perfaqesuesve te bankave pilote dhe te atyre bankave qe jane ende ne pritje te implementimit te ketij programi, por edhe te perfaqesuesve te subjekteve te tjera raportuese.

Gjate vitit 2006 ka perfunduar hartimi dhe botimi “on- line” i faqes se internetit te DPPPP([www.fint.gov.al](http://www.fint.gov.al)), e cila permban, vec informacioneve te pergjithshme mbi NIF shqiptar, strukture, organizimit, aktivitetit, misionit dhe objektive te saj, edhe tema te tjera te rendesishme qe mundesojne marrjen e informacioneve te domosdoshme nga publiku i gjere ne lidhje me keto dy fenomene kercenuese te viteve te fundit. Azhornimi i vazhdueshem behet nga Zyra e Marredhenieve me Publikun, nje pjese e rendesishme e strukture se re te DPPPP-se. Ky web-site permban gjithashtu edhe adresa kontakti apo numra telefonash kontakti, qe mundesojne shkembimin e informacioneve(jo financiare), dhenien e pergjigjeve mbi keto fenomene si dhe mirepritjen e sugjerimeve nga ana e publikut te gjere.

Azhornimi i metejshem i web-site dhe Zyra e Marredhenieve me Publikun, mendohet te mbushe disa nga boshlleqet ne mungesen e theksuar te informacionit qe vihet re ne publikun e gjere.

## **2. Inspektimet e realizuara, subjektet e kontrolluara dhe masat e propozuara.**

Me riorganizimin e NIF-it eshte shtuar dhe kompetenca e inspektimeve gje e cila e ben pergjegjese kete strukture per identifikimin, ndergjegjesimin dhe detyrimin e subjekteve raportuese sipas kerkesave te ligjit per fillimin e raportimit te subjekteve raportuese.

Objektivat e NIF-it ne kete drejtim jane ne perqendrimin e vemendjes ne subjektet raportuese qe te nisin te dorezojne raporte te transaksioneve te vlerave (RTV) dhe raporte te aktiviteteteve te dyshimta (RAD). Kjo eshte realizuar nepermjet planifikimit, te zbatimit te inspektimit ne vend dhe plotesimit te raportit te inspektimit.

Per periudhen Janar – Dhjetor 2006 mbeshtetur ne programin e inspektimit dhe dhenies se asistences subjekteve raportuese jane kryer nje sere inspektimesh sipas subjekteve si me poshte:

<b>Nr.</b>	<b>Lloji i Subjektit</b>	<b>Nr Subjekteve Gjithsej</b>	<b>Nr Subjekteve te inspektuara</b>	<b>Perqindja e inspektimit</b>
<b>1</b>	Organet Doganore	23	14	60.8
<b>2</b>	Lojrat e Fatit dhe	49	9	18.3

	Kazinote			
3	Shoqerite e Sigurimeve	12	4	33.3
4	Zyrat e Kembimeve Valutore	48	5	10.4
5	Tregetia e Mjeteve te Transportit	12	12	100
6	Z R P P	37	10	27
7	Organizatat Jofitim Prurese	-	16	-
8	Agjencite e Udhetimit	117	26	22.2
9	Organet Tatimore	37	4	10.8
	<b>Totali</b>	<b>335</b>	<b>100</b>	

Problemet që janë verifikuar në 100 subjektet e inspektuara për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftes kundër financimit të terrorizmit, kryesisht kanë të bëjnë me:

- Ngritjen dhe funksionimin e njësive raportuese, emërimin e personit përgjegjës për raportimin e Raporteve të Aktivitetit të Dyshimtë (RAD);
- procedurat e identifikimit të klientëve, ruajtjes dhe administrimit të dokumentacionit;
- përgatitjen dhe zbatimin e rregullave dhe udhëzimeve të brendshme për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftes kundër financimit të terrorizmit;
- shkallën e informimit të punonjësve për procedurat ligjore dhe masat e tjera për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftes kundër financimit të terrorizmit;
- identifikimin e nevojave për trajnim, masat që janë marrë e parashikohen të meren nga subjektet, në këtë drejtim;
- parregullsitë dhe çështje të tjera të mundshme në drejtim të parandalimit të pastrimit të parave dhe luftes kundër financimit të terrorizmit;
- vështirësitë dhe pengesat që konstatohen në zbatim të ligjit;
- rolin e kontrollit të brendshëm në këtë drejtim;
- rritjen e komunikimit dhe institucionalizimin e bashkëpunimit me autoritetin përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave;
- njohjen dhe zbatimin e urdherave të Ministrit të Financave të cilët kanë të bëjnë me ngrirjen dhe sekuestrimin e llogarive apo pasurive të shtetasve, fondacioneve dhe shoqatave të cilat rezultojnë të shpallur në listen e financuesve të terrorizmit të shpallur nga Organizata e Kombeve të Bashkuara;
- rritjen e kujdesit që subjektet të veprojnë në përputhje me ligjin.

***Zhvillimet në zyrat e subjekteve raportuese për dorëzimin e RTV-ve dhe RAD-ve janë përqendruar kryesisht në problemet që kanë të bëjnë me:***

- përshtatshmerine e politikave dhe procedurave kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në përdorimin e informacionit nga njësia mbikqyrëse;
- verifikimin në se janë regjistruar transaksionet e kërkuara nga ligji;
- rishikimin e regjistrave të subjekteve të kërkuara nga ligji dhe të identifikimit nëse transaksionet janë raportuar përmes një RTV ose RAD;

- komunikimit me zyrtarë të lartë dhe punonjës të zyrave të regjistrimit për të identifikuar vështirësitë dhe problemet e mundëshme si dhe rrugët për përmirësimin e gjëndjes;
- testimin e saktësisë së RTV dhe RAD të dërguara nga subjektet krahasuar më të dhënat në regjistrin e brendshëm;
- vlerësimin e nevojave për trajnim të personave përgjegjës të subjektit për të mundësuar respektimin e kërkesave të ligjit;
- identifikimin e pikave të forta dhe pikave të dobta të raportimit lidhur me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;
- diskutimet me drejtuesit e subjektit, për të parë se si ata planifikojnë ti kapërcejnë këto dobësi.

***Asistencë teknike për zbatimin korrekt të ligjit.***

- Lidhur me rregulloret e brendëshme për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftës kundër financimit të terrorizmit;
- për pozicionet dhe rolet e personave përgjegjës në zyrat e subjektit;
- konsulta lidhur me plotësimin dhe dërgimin e raporteve dhe mënyren e raportimit etj.

Gjate kryerjes se inspektimeve ne 100 subjekte jane vene re mjaft mangesi ne zbatimin e ligjit dhe akteve nenligjore si me poshte:

Pothuajse ne te gjitha subjektet e inspektuara, njesite raportuese te tyre nuk ishin krijuar dhe nuk funksiononin, sipas percaktimeve te bera ne aktet ligjore dhe nenligjore ku Autoritetet Mbikqyrerese dhe ato Licensuese, duhet te krijojne Njesite Qendrore pergjegjese per te identifikuar dhe mbledhur transakcionet e dyshimta. Ne kete kuader Drejtuesit e institucioneve duhet te emerojne punonjes te nivelit te larte te menaxhimit per te drejtuar Njesite Qendrore, te cilet do te jene pika e kontaktit me Autoritetin Pergjegjes.

Në mbështetje të nenit 14 te Ligjit nr. 8610 datë 17.05.2000, “Për parandalimin e pastrimit të parave” të ndryshuar, jane parashikuar dhe kundravajtjet administrative, lidhur me moszbatimin e detyrave të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore. Ne rastet kur vërehen kundravajtje administrative të cilat nuk përbëjnë vepër penale atehere subjekti, punonjesi i punesuar prane subjektit apo drejtusi i nivelit te larte i subjektit sipas konstatimit te pergjegjesise, denohet me gjobe.

Ne kete kuader me qellim parandalimin dhe forcimin e luftes kunder pastrimit te parave/ financimit te terrorizmit, synojme qe nepermjet institucioneve qe kane te bejne me luften kunder ketyre krimeve te pershpejtojne masat dhe te nxisim strukturat per nje bashkepunimin dhe bashkeveprim sa me te ngushte kunder ketyre fenomeneve duke i konsideruar subjektet si partnere ne kete lufte dhe ne te ardhmen per cdo kundravajtje administrative do popozojme masat perkatese.

### 3. Statistikat e raporteve te marra.

#### 3.1 Raporte te derguara nga DPPPP ne Prokurori, Ministri te Brendshme, etj, per ndjekje te metejshme te procedurave.

Nr	Pershkrimi	Viti 2006
1	Derguar ne Banken e Shqiperise	19
2	Derguar ne DPT per fshehje te ardhurash	8
3	Derguar ne Polici per investigim	11
4	Kallezim ne prokurori	3
	- per pastrim parash	2
	- financim terrorizmi	1
5	Te denuar (pastrim parash)	0
6	Ne gjykim	0
7	<b>Masa te marra :</b>	
	1.Urdhera ngrirje (asete, pasuri, investime) nga keto :	8
	- Pastrim parash	0
	-Financim terrorizmi(urdhera shtese)	8
	2. Llogari bankare te ngrira	7
	- Pastrim parash	0
	- Financim terrorizmi	7

Ne zyren e Prokurorit jane referuar ato raste (3 gjithsej) qe kanë patur elemente te mjaftueshem te dyshimit te pastrimit te parave ose financimit të terrorizmit, si dhe elemete komprometuese ose te provave per te filluar një procedim penal ose investigim te metejshem.

Ne Policine Kriminale, (Drejtorine e Luftes Kunder Krimin te Organizuar) ne Ministrine e Brendshme, jane referuar ato raste qe kanë patur nevojë për investigim policor dhe kompletimin me elemente te tjere para se ti kalojne Prokurorise per ndjekje penale. Pas përfundimit te investigimit policor, kallezimi në organin e prokurorise mund te behet prej policise duke njoftuar Autoritetin Pergjegjes (NIF) ose nepermjet ketij te fundit pa perjashtuar edhe rastin e referimit te perbashket. Pervec ketyre jane derguar per ndjekje te metejshme te procedurave edhe raste per evazion fiskal ne organet tatimore apo raste per moslicensim ne Banken e Shqiperise.

#### 3.2 Me Banken e Shqiperise.

Ne Banken e Shqiperise, per vitin 2006, jane derguar 19 raporte. Verejtjet e dhena bankave te nivelit te dyte kane qene si rezultat i gabimeve ne plotesimin e formulareve RTV dhe RAD, i dergesave me vonese te formulareve ne DPPPP si dhe ndryshimi i shpeshte i personave te kontaktit neper keto banka. Duke qene se bashkepunimi me bankat e nivelit te dyte ka qene i mire si ne fushen e parandalimit te pastrimit te parave ashtu edhe ne luften kunder financimit te terrorizmit nga ana e Drejtorise sone u realizuan takime me te gjithë personat e kontaktit ku u diskutuan te gjitha mangesite si ne plotesimin e formulareve RTV dhe RAD ashtu edhe ne



veshtiresite e hasura nga bankat ne kuadrin ligjor. Perverc kontakteve te drejteperdrejta me disa banka jane organizuar trajnime me stafet perkatese qe mbulojne fushen e parandalimit te pastrimit te parave dhe financimin e terrorizmit. Ne keto seminare trajnime eshte shpjeguar Ligji ekzistues per parandalimin e pastrimit te parave, Ligji per masat kunder financimit te terrorizmit, Udhezimet ne zbatim te tyre, jane shpjeguar menytrat e plotesimit te formulareve RTV dhe RAD si dhe indikatorret te cilet duhet te kihen parasysh ne rastet e aktiviteteteve te dyshimta. Gjithashtu ne keto seminare stafi i punonjesve te ketyre bankave eshte njohur edhe me 40+9 rekomandimet e FATF.

### **3.3 Me Drejtorine e Pergjithshme te Tatimeve.**

Ne Drejtorine e Pergjithshme te Tatimeve, per vitin 2006 jane derguar per fshehje te te ardhurave dhe shmangie nga detyrimet tatimore 8 raste, nder te cilat 4 kompani dhe disa persona fizike (shtetas shqiptare).

Rastet e mesiperme jane derguar ne Drejtorine e Pergjithshme te Tatimeve si rezultat i kryerjes se aktiviteteteve te palicensuara, i perfitimit te te ardhurave nga burime te padeklaruara ne organet tatimore, si rezultat i kryerjes se evazionit fiskal dhe transakcioneve cash.

### **3.4 Me Drejtorine e Policise se Shtetit.**

Ne Drejtorine e Policise se Shtetit, per vitin 2006 jane derguar per ndjekje te metejshme 11 raste per 11 shtetas shqiptare.

Rastet e mesiperme jane derguar ne Drejtorine e Policise se Shtetit si rezultat i identifikimit te perfitimit te te ardhurave nga burime jo te ligjshme.

### **3.5 Me zyren e Prokurorit te Pergjithshem.**

Ne Zyren e Prokurorit te Pergjithshem, per vitin 2006, jane bere **2 kallezime** per ndjekje penale per implikime ne **pastrimin e parave** dhe **1 kallezim** per implikime ne **financimet terroriste**. NIF ka qene e ngarkuar jo vetem me luften kunder pastrimit te parave por edhe ne luften kunder financimit te terrorizmit. Ky funksion eshte mbeshtetur nga ligji **Nr.9258, date 15/07/2004 "Per masat kunder financimit te terrorizmit"** i cili ka krijuar mbeshtetjen ligjore per parandalimin e perdorimit te fondeve qe burojne nga veprimtaria kriminale per financimin e mundshem te terrorizmit.

## **4. Urdher ngrirjet sipas dates, numrit te llogarise, emrit dhe sasise.**

Ne zbatim te Ligjit nr.9258 date 15.07.2004. "Per masat kunder financimit te terrorizmit", nga Ministria e Financave u hartua e me pas nga Keshilli i Ministrave u miratua Vendimi nr.718 date 29.10.2004 "Per listen e personave te shpallur si financues te terrorizimit". Mbi kete baze nga verifikimet me subjektet e ligjit jane pergatitur, nxjerre dhe botuar ne fletore zyrtare tete urdhera sekuestrimi te Ministrit te Financave si me poshte:

## **Vitet 2004 - 2005**

1. Urdheri nr.2 date **24.12.2004** “Per sekuestrimin e asteteve te shtetasit arab Yassin Kadi dhe te kompanive te lidhura me te”.
2. Urdheri nr.5 datë 10 .03.2005 “Per sekuestrimin e asteteve te shtetasit Nabil Abdul Sayadi”,
3. Urdheri nr.6 datë 10.03.2005 “Per sekuestrimin e asteteve te shtetasit Patricia Rosa Vinck”;
4. Urdheri nr.7 datë,10 .03.2005 “Per sekuestrimin e asteteve te fondacionit "Global Relief Foundation" (GRF)”;
5. Urdheri nr.8 datë 10 .03.2005 “Per sekuestrimin e asteteve te fondacionit “Ringjallja e Trashëgimisë Islame”, e njohur dhe si “Revival Of Islamic Heritage Society”, RIHS”;
6. Urdheri nr.9 datë 10.03.2005 “Per sekuestrimin e asteteve te fondacionit “Taibah of Islamic”, e njohur dhe si Shoqata Ndërkombëtare e Ndhimave”,
7. Urdheri nr.10 datë 10.03.2005 “Per sekuestrimin e asteteve te Fondacionit "Al Haramania",
8. Urdheri nr.6 date 25.11.2005 “Per sekuestrimin e asteteve te shtetasit jordanез Abdyl Latif Saleh, ne baze te vendimit (VKM) shtese nr.671 date 26.10.2005”.

## **Viti 2006**

1. Urdheri nr.20, dt.13.06.2006 “Per disa ndryshime ne Urdherin nr.9 datë 10.03.2005 “Per sekuestrimin e asteteve te fondacionit “Taibah of Islamic”, e njohur dhe si Shoqata Ndërkombëtare e Ndhimave”,
2. Urdheri nr.21, dt 13.06.2006 “Per disa ndryshime ne Urdherin nr.10 datë 10.03.2005 “Per sekuestrimin e asteteve te Fondacionit "Al Haramania",
3. Urdheri nr.22, dt. 13.06.2006 “Per disa ndryshime ne Urdherin nr.6 date 25.11.2005 “Per sekuestrimin e asteteve te shtetasit jordanез Abdyl Latif Saleh, ne baze te vendimit (VKM) shtese nr.671 date 26.10.2005”.
4. Urdheri nr.27, dt.05.07.2006 “Per disa ndryshime ne Urdheri nr.2 date 24.12.2004 “Per sekuestrimin e asteteve te shtetasit arab Yassin Kadi dhe te kompanive te lidhura me te”.
5. Urdheri nr.28, dt.05.07.2006 “Per disa ndryshime ne Urdherin nr.6 date 25.11.2005 “Per sekuestrimin e asteteve te shtetasit jordanез Abdyl Latif Saleh, ne baze te vendimit (VKM) shtese nr.671 date 26.10.2005”.
6. Urdheri nr.29, dt.05.07.2006 “Per disa ndryshime ne Urdherin nr.9 datë 10.03.2005 “Per sekuestrimin e asteteve te fondacionit “Taibah of Islamic”, e njohur dhe si Shoqata Ndërkombëtare e Ndhimave”.
7. Urdheri nr.30, dt.05.07.2006 “Per disa ndryshime ne Urdheri nr.9 datë 10.03.2005 “Per sekuestrimin e asteteve te fondacionit “Taibah of Islamic”, e njohur dhe si Shoqata Ndërkombëtare e Ndhimave”,
8. Urdheri nr.36, dt.27.11.2006 “Per disa shtesa ne Urdherin nr.2,date 24.12.2004 “Per sekuestrimin e asteteve te shtetasit arab Yassin Kadi dhe te kompanive te lidhura me te”.

**Llogarite bankare te ngrira me urdhrat shtese nr 27;28;29;30 dhe 36 te Ministrit te Financave per vitin 2006 te evidentuara ne tabelen e meposhtme.**

nr	Urdheri shtese		Mbeshtetur ne Urdhrin meparshem		sasia			numri llogarise	Banka	Shoqeria/individidi	
	nr	date	nr	date	Llog Bank	Vlefte					
		Llog Bank				Lek	usd				eur
1	27	05.07.06	2	03.12.2004	1	411181			0100002314	RFZ	Shoq. medicare
2	27	05.07.06	2	03.12.2004	1		88392		110006966	BKT	Shoq. Karavan
3	27	05.07.06	2	03.12.2004	1	37926			110006966	BKT	Shoq. Karavan
4	27	05.07.06	2	03.12.2004	1	121800			110002151	BKT	Shoq. Medicare
5	28	05.07.06	6	25.11.2005	1		0		000170	BNT	Individ Abdyl Saleh Lati
6	28	05.07.06	6	25.11.2005	1	4071			0100315426	RFZ	Fondacioni FLS
7	28	05.07.06	6	25.11.2005	1			18567	801015426	RFZ	Individ Abdyl Saleh Lati
		<b>Totali</b>			<b>7</b>	<b>574,978.00</b>	<b>88,392.00</b>	<b>18,567.00</b>			

**Asetet e sekuestruara me urdhrat shtese nr 27;28;29;30 dhe 36 te Ministrit te Financave per vitin 2006 te evidentuara ne tabelen e meposhtme.**

		ASETE				Sasia		
1	28	05.07.06	6	25.11.2005	2 ap	150.2 m <sup>2</sup>	ZK 2315 Kukes 78 m <sup>2</sup> +72.2 m <sup>2</sup> = 150.2 m <sup>2</sup>	Individ : Abdy Latif Saleh
2	28	05.07.06	6	25.11.2005	1 truall	98.9 m <sup>2</sup>	ZK 2315 Kukes 98.9 m <sup>2</sup> = 98.9 m <sup>2</sup>	Individ : Abdy Latif Saleh
3	29	05.07.06	9	10.03.06	3 ndertesa	726 m <sup>2</sup>	Pasurite nr 1/31/1,1/33/1,1/28/1 me ref.1360,1361,1362 Bulqize	Fondacioni "Taibah"
4	30	05.07.06	10	10.03.05	1 Vile 2-katshe	157 m <sup>2</sup>	Vile 2 katshe 157 m <sup>2</sup> sip 432 m <sup>2</sup> e ZK 8260 Tirane	Fond. "A Haramanin"
5	36	26.11..2006	2	03.12.04	4 Ap	370 m <sup>2</sup>	Rr. "V.Pasha" 2/2/5 Rr "R. Çollaku " sh/7/86/ Rr "B. Curri" 8/1/3 Rr Durrësit 34/4/79	Shoqeria "Loxhall" shpk
6	36	26.11..2006	2	03.12.04	1 shtepi	270 m <sup>2</sup>	Nje shtepi dy katshe ne fshatin Selite e Vogel	Shoqeria "Loxhall" shpk
7	36	26.11.2006	2	03.12.04	1(nje) lokal	175 m <sup>2</sup>	LOKAL - Embeltore Rr Durrësit	Shoqeria "Loxhall" shpk
8	36	26.11.2006	2	03.12.04	2 (dy) dyqane	397 m <sup>2</sup>	Dyqan ish gjelltoze Rr e Durrësit dyqan (Ish permanenti) RR Elbasanit	Shoqeria "Loxhall" shpk
9	36	26.11.2006	2	03.12.04	1 (nje) magazine	4437 m <sup>2</sup>	Magazinat Nr. 1 - 8 ne Laprake mbi truallin 4437 M2 Rr."Pandi Dardha"	Shoqeria "Loxhall" shpk
10	36	26.11.2006	2	03.12.04	1 (nje) truall	22000 m <sup>2</sup>	Nje truall me sip 22.000 M2 ne fshatin Yzberisht  Zona kadastrale 3866	Shoqeria "Loxhall" shpk
		<b>Totali</b>			<b>17 asete</b>	<b>28,781.10 m<sup>2</sup></b>		

**5 - Raporte te marra nga subjektet e zbatimit te Ligjit per Parandalimin e Pastrimit te Parave**

Ne zbatim te ligjit per parandalimin e pastrimit te parave subjektet e tij jane te detyruara ti japin informacion DPPPP si me poshte:

1. Subjektet raportuese sipas nenit 3 te ligjit raportojne per çdo dyshim per pastrim parash dhe per veprime financiare mbi shumen e 20 milion lekeve.
2. Organet doganore sipas nenit 10 te ligjit, raportojne per çdo transakcion te aktivitetit te dyshimte (RAD) dhe ne pikat e kalimit kufitar per shumet ne cash te udhetareve, mbi 1 milion leke.
3. Organet tatimore sipas nenit 10/1 te ligjit, raportojne per çdo transakcion te aktiviteteteve te dyshimta (RAD).

Organet qe licensojne personat fizike dhe juridike sipas nenit 10/2 te ligjit, raportojne per cdo dyshim per pastrim parash dhe per veprime financiare mbi vleren e 20 milion lekeve

Nr	PERSHKRIMI	RTV 2006	RAD 2006
2.1	Bankat	48580	13
2.2	Institucione te tjera	5	1
2.3	Tatimet	1	0
2.4	Doganat (deklarimi cash ne kufi)	142	0
2.5	ZRPP	0	0
2.6	Banka e Shqiperise	3	0
	<b>TOTALI</b>	<b>48731</b>	<b>14</b>

### 5.1 Raporte te marra nga Bankat

Gjate vitit 2006, nga *bankat* jane derguar sipas detyrimeve ligjore **48731 RTV** (raporte te transaksioneve te vlerave). Krahasuar me vitin 2005 kjo vlere eshte shume me e larte dhe sipas muajve rezultojne te jene derguar:

#### RTV 2006

Nr	Muaji	Shuma mujore
1	Janar	4445
2	Shkurt	4088
3	Mars	3653
4	Prill	3446
5	Maj	3783
6	Qershor	2798
7	Korrik	4047
8	Gusht	4752
9	Shtator	3826
10	Tetor	4508

<b>11</b>	Nentor	4060
<b>12</b>	Dhjetor	5325
	<b>Totali</b>	<b>48731</b>

Gjate vitit 2006, jane derguar sipas detyrimeve ligjore **14 RAD** (raporte te aktivitetit te dyshimte),

Keto RAD jane derguar pas kontakteve direkte te perfaqesuesve se Drejtorise se Analizes me perfaqesues te bankave te nivelit te dyte, pas trajnimeve te organizuara me punonjes te disa bankave dhe pas shqetesimit te ngritur nga Drejtori i Pergjithshem i DPPPP ne mbledhjen e Komitetit Kombetar te Bashkerendimit te Luftes kunder Pastrimit te Parave dhe Financimit te Terrorizmit.

Gjate vitit 2006, nga institucionet e tjera te zbatimit te ligjit jane derguar 5 informacione per ndjekje te metejshme te cilat ne i kemi konsideruar si RTV (raporte te transkacioneve te vlerave).

## 5.2 Raporte te marra nga Dega e Tatimeve

Gjate vitit 2006, nga *Dega e Tatimeve* Tirane eshte derguar **1 RTV** (informacion per ndjekje te metejshme) lidhur me disa shkelje te konstatuara. Ne fakt Dega e Tatimeve Tirane duhet te zbatonte procedurat ligjore per pergatitjen e formularit te sinjalizimit RAD dhe ta dergonte kete sinjalizim nepermjet autoritetit te saj mbikeqyres qe eshte Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve.

Duhet te theksojme se bashkepunimi me DPT ka lene per te deshiruar ne disa drejtime:

1. Njesia Qendrore qe sherben si Autoriteti Mbikeqyres persa i perket zbatimit te ligjit per Parandalimin e Pastrimit te Parave (Personi i Kontaktit), ne kete subjekt nuk ka funksionuar sipas kriterave te percaktuara ne ligj,
2. Vonesa te theksuara ne dergimin e informacioneve te kerkuara nga DPPPP.

Mungesa e raportimit te aktiviteteve te dyshimta.

## 5.3 Raporte te marra nga Drejtoria e Pergjithshme e Doganes

Gjate vitit 2006, nga *Drejtoria e Pergjithshme e Doganave* ne kuader edhe te marrjes se masave per deklarimin "CASH" ne kufi kane filluar edhe deklarimet dhe raportimet e para te personave qe transportojne me vete vlera monetare mbi 1.000.000 leke. Duhet theksuar fakti se nuk kemi patur asnje RAD te derguar nga Autoritetet Doganore dhe nuk ka funksionuar njesia qendrore e mbikqyrjes e zbatimit te ligjit nr. 8610 e vitit 2001 mbi luften kunder Pastrimit te Parave dhe Financimit te Terrorizmit.

Autoriteti Mbikeqyres (Personi i Kontaktit) edhe ne kete subjekt nuk ka funksionuar sipas kriterave te percaktuara ne ligjin 8610.

Nuk ka patur asnje RAD te derguar nga autoritetet doganore megjithe inspektimet e bera nga DPPPP dhe kerkesat tona te vazhdueshme per raportimin e rasteve te dyshimta te percaktuara me udhezim te Ministrit te Financave.

## 5.4 Raporte te marra nga Zyra Qendrore e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme

Gjate vitit 2006, nga *ZVRPP-te* nuk kemi pasur asnje RTV. Megjithe inspektimet e kryera nga Drejtoria e Inspektimit dhe kontaktet direkte te Drejtorit te Pergjithshem

per te bindur autoritetet per te zbatuar ligjin dhe per te raportuar RTV, neglizhenca e tyre ka penguar punen e Drejtorise Tone. Gjithashtu edhe njesia qendrore ne zbatim te ligjit nuk ka funksionuar

## 6 - Shkembimi i informacionit (te dhena dhe te marra) me subjektet e ligjit dhe me institucionet e tjera te zbatimit te ligjit.

### 6.1 Informacione te shkemyera nga NIF-i me institucione te tjera:

Nr	PERSHKRIMI	Informacione te kerkuara per 2006	Pergjigje dhe Informacione te marra per 2006
2.1	Bankat e nivelit te dyte	1763	1615
2.2	DPTatimeve	97	76
2.3	DPDoganave	8	8
2.4	Ministria e Brendshme	50	30
2.5	SHISH	28	10
2.6	ZQRPP	65	53
2.7	ILDKP	2	2
2.8	Banka e Shqiperise	2	2
2.9	Ministria e Drejtesise	0	0
3.0	Zyra e Rregjistrimit Tregtar	4	6
3.1	Prokuroria	37	38
3.2	Min.Fin,Kabineti, MPJ etj	16	15
3.3	Homologet & A. A.	32	32
3.4	Ministria e Ekonomise	3	0
		2107	1893

Per shkembimin e informacionit Drejtoria e Analizes eshte mbeshtetur ne kuadrin ligjor te perdorur ne fushen e parandalimit te pastrimit te parave dhe ate kunder financimit te terrorizmit si dhe ne ligjin per klasifikimin e dokumentave "Sekret Shteteror" dhe te akteve te tjera nenligjore ne zbatim te tyre :

- Ligji nr. 8610, date 17.05.2000 "Per parandalimin e pastrimit te parave" i ndryshuar dhe udhezimeve ne zbatim te tij.
- Ligji nr.9258, date 15/07/2004 "Per masat kunder financimit te terrorizmit" dhe udhezimeve ne zbatim te tij.
- Ligji nr.8457, date 11.02.1999 "Per informacionin e klasifikuar "sekret shteteror" i permiresuar dhe te udhezimeve ne zbatim te tij.

Pas verejtjeve te bera dhe trajnimit te stafit te Drejtorise se Analizes nga DSIK, cilesia e shkembimit te informacionit me subjekte dhe institucionet e zbatimit te ligjit per parandalimin e pastrimit te parave eshte permiresuar.

## 7 – Krahasimi me nje vit me pare (Viti 2005)

**7.1 Raporte te derguara nga DPPPP ne Prokurori, Ministri te Brendshme,etj, per ndjekje te metejshme te procedurave.**

Nr	Pershkrimi	Viti 2005	Viti 2006
1	Derguar ne Banken e Shqiperise	0	19
2	Derguar ne DPT per fshehje te ardhurash	0	8
3	Derguar ne Polici per investigim	10	11
4	Kallezim ne prokurori	11	3
	- per pastrim parash	4	2
	- financim terrorizmi	7	1
5	Te denuar (pastrim parash)	0	0
6	Ne gjykim	0	0
7	<b>Masa te marra :</b>		
	<b>1.Urdhera ngrirje (asete, pasuri, investime) nga keto :</b>	7	8
	- Pastrim parash	0	0
	-Financim terrorizmi	7	8
	<b>2. Llogari bankare te ngrira</b>	12	7
	- Pastrim parash	0	0
	- Financim terrorizmi	12	7

**7.2 - Raporte te marra nga subjektet e zbatimit te Ligjit per Parandalimin e Pastrimit te Parave**

Nr	PERSHKRIMI	RTV 2005	RTV 2006	RAD 2005	RAD 2006
2.1	Bankat	26869	46507	6	14
2.2	Institucione te tjera	123	5	21	1
2.3	Tatimet		1	16	
2.4	Doganat (deklarimi cash ne kufi)		114	33	
2.5	ZRPP		0	13	
2.6	Banka e Shqiperise		3		
2.7	Ministri e Brendshme			18	
	<b>TOTALI</b>	26992	46630	107	15

**7.3 Inspektime te kryera.**

Nr.	Lloji i subjektit	Viti 2005	Viti 2006
1	Organet Doganore	-	14
2	Lojrat e Fatit dhe Kazinote	-	9
3	Shoqerite e Sigurimeve	11	4
4	Zyrat e Kembimeve Valutore	-	5
5	Tregetia e Mjeteve te Transportit	-	12



<b>6</b>	Z R P P	-	10
<b>7</b>	Organizatat Jofitim Prurese	-	16
<b>8</b>	Agjencite e Udhetimit	-	26
<b>9</b>	Organet Tatimore	-	4
	<b>Totali</b>	<b>11</b>	<b>100</b>

## **8. Bashkëpunimi Ndërkombëtar**

### **8.1 Bashkëpunimi me Organizata Ndërkombëtare**

Fenomeni i pastrimit të parave dhe ai i financimit të terrorizmit, perben një rrezik jo vetëm në realitetin shqiptar, por dhe në mbare botën. Si rrjedhim, për të bërë balle këtij rreziku si dhe shtrirjes që ai po njeh, është e nevojshme që të intensifikohen përpjekjet në luftën e përbashkët. Në këtë kuader, NIF-i shqiptar bashkëpunon me organizatat ndërkombëtare të cilat kanë dhënë ndihmesën e tyre në përmirësimin e kuadrit ligjor në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe kundër financimit të terrorizmit.

Vlen të përmendim këtu, bashkëpunimin me Departamentin Amerikan të Shtetit nëpërmjet përfaqësuesit të tij si këshilltar pranë DPPP-se.

Bashkëpunimin e NIF-it shqiptar me përfaqësuesit e Fondit Monetar Nderkombëtar, të cilët nëpërmjet një misioni të posaçëm, asistuan në ndryshimin e kuadrit ligjor në fushën e parandalimit të pastrimit të parave, në përputhje të plotë me 40+9 Rekomandimet e Task Forces së Veprimit Financiar (FATF), dhe me rekomandimet e raportit të vlerësimit të raundit të tretë të Komitetit MONEYVAL.

Gjithashtu, kemi bashkëpunuar dhe me organizatat europiane që veprojnë në Shqipëri, siç janë: Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin Europian (OSBE), Komuniteti Europian (BE), në kuader të ftesës për pjesëmarrje në grupin e punës të ngritur nga FMIN-ja, për sa përmendëm më sipër. Ndërsa, bashkëpunimi me Misionin e Asistencës Policore të Komunitetit Europian në Shqipëri (PAMECA), lidhur me ndihmesën e dhënë në redaktimin e perkthimit të Ligjit 8610, datë 17.05.2000 “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave” pas ndryshimeve të propozuara nga ky grup pune.

#### ***Bashkëpunimi me Grupin Egmont dhe Sherbimet partnere homologe***

Aktualisht, NIF-i shqiptar është anëtar i këtij grupi që në 23 Korrik të vitit 2003 (me fillimin e Sesionit të 11<sup>te</sup> Plenar të Grupit Egmont mbajtur në Sidney, Australi). Duke patur parasysh këtë fakt, anëtarësimi në Grupin Egmont, i cili luan rolin e një organizate ndërkombëtare me qëllim bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, bën të mundur shkëmbimin e informacioneve të inteligjencës financiare edhe me njesitë homologe në botë.

Shkëmbimi i informacionit me homologët tanë në botë, bazohet në parimet e Grupit Egmont, duke respektuar konfidencialitetin dhe palen homologe në kërkesën për informacion, me qëllim mos-shpërnadarjen e tij pa pelqimin paraprak të njesitë tjeter.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2006, janë dërguar 32 kërkesa për informacion Njesive Homologe dhe kanë ardhur 33 kërkesa të tilla, në lidhje me ata individë apo kompani që të ardhurat e tyre të përftuara në mënyrë të paligjshme nga veprimtari kriminale siç është pastrimi i parave dhe ai i financimit të terrorizmit, i përdorin për të fshehur gjurmët në aktivitetet biznesi apo në mënyrë të tjera.

Bashkepunimi ne kete kuader po forcohet gjithnje e me shume edhe si rezultat i memorandumeve dypaleshe te bashkepunimit, te cilat po nenshkruhen mes Shqiperise dhe vendeve te tjera. Jane nenshkruar gjithsej 26 Memorandume Mirëkuptimi me njesite tona homologe. Per vitin 2007, eshte ne fokus nenshkrimi i nje MOU-je me Njesite Homologe te meposhtme:

FINTRAC	–	Kanada
MASAK	–	Turqi
IMPA	-	Izrael
AUSTRAC	–	Australi
UIC	–	Itali
CFCI	–	Greqi
JUOBA	–	Luksemburg
MOT	–	Hollande
UAF	–	Paraguaj

Vlen te permendim ketu, bashkepunimin me palen australiane (AUSTRAC), e cila ka treguar interes per nenshkrimin e nje Memorandumi Mirekuptimi me ne. Po ashtu, jane shenuar hapa te rendesishem me NIF-in turk (MASAK), me te cilin faza e nenshkrimin te memorandumit, mendohet te vije pas kalimit ne Asamblene e Madhe Turke te projektligjit te tyre KPP. Ndersa, njesia homologe izraelite (IMPA) si dhe njesia homologe e Paraguajit (UAF), jane shprehur te gatshme per nenshkrimin e nje Memorandumi Bashkepunimi me NIF-in shqiptar. Nderkohe qe kemi ndeshur veshtiresi ne komunikim me homologet tane greke dhe italiane.

### ***Bashkepunimi ndermjet institucioneve vendase***

Ne kuadrin e marreveshjeve nderinstitucionale, te cilat e kane zanafillen qe ne vitin 2002, NIF-i shqiptar nenshkroi Memorandumin e Mirekuptimit “Mbi bashkepunimin nderinstitucional per luften kunder pastrimit te parave”, ne te cilin perfshihen Ministria e Financave, Ministria e Brendshme, Prokuroria e Pergjithshme, Banka e Shqiperise dhe Sherbimi Informativ Shteteror.

Ne 28 Prill 2006, u nenshkrua Memorandumi I Bashkepunimit midis DPPPP dhe Inspektoriatit te Larte te Deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive, i cili sherben per realizimin e bashkepunimit te ndersjellte ndermjet dy paleve, ne: pershejtimin e procedurave ligjore ne rastet e verifikimit te llogarive bankare, asetave dhe pasurive te tjera, jashte territorit te Republikes se Shqiperise; bashkerendimin e veprimeve te ILDKP-se dhe te DPPPP-se me njesite e tjera homologe, ne baze te ligjit te PP; koordinimin dhe mbledhjen e te dhenave personale qe lidhen me llogarite bankare, asetet, pasurite dhe detyrimet financiare te Personave te Ekspozuar Politikisht (PEP).

## **8.2 Mbështetja e asistencës së huaj për NIF-in Shqipëtar**

Departamenti Amerikan i Thesarit ka dhene asistencë teknike të vazhdueshme që nga ngritja e NIF nëpërmjet atashimit prane kesaj strukture te nje këshilltari teknik rezident. Gjithashtu asistencë eshte dhene edhe ne formen e trainimeve.

Asistence ka ofruar CAFAO (Zyra e Asistences per Doganat dhe Tatimet ne Shqiperi), nëpërmjet trainimit me temë “Mbi pastrimin e parave”.

PAMECA (Misioni i Asistences Policore te Komunitetit European ne Shqiperi) organizoi seminarin me temë “Mbi legjislacionin vendas KPP/KFT”  
FMN ka dhene asistence teknike ne rishikimin e legjislacionit dhe sistemit të masave kundër pastrimit të parave në vendin tonë.

Misioni i OSCE në Tiranë ka ndihmuar në dizenjimin e një programi kompjuterik të dhënash (për hollësi të mëtejshme shiko Sesionin 6 “Zhvillimi i Teknologjisë së Informacionit”).

## **9. Permirosimi i Legjislacionit**

Drafti i projekt-ligjit te ri “Për Parandalimin e Pastrimit te Parave”ka përfunduar. Ky projekt –ligj u punua me grupin e Përfaqësuesve të Misionit të FMN. Drafti i ri me amendimet e bëra do të përmbajë të gjitha rekomandimet e bëra nga FMN, Moneyval, Departamenti Amerikan i Thesarit duke bërë perpjekje për të qënë në përputhje të plotë me standartet e Egmond Group dhe 40 + 9 rekomandimet e FATF-se. Ky draft pritet te miratohet brenda gjashte mujorit te dyte te vitit 2007.

## **10. Permirosimi i Teknologjise se Informacionit ne DPPPP**

Ne strukturen e saj DPPPP ka nje Specialist IT qe kujdeset jo vetem per mirembajtjen e hardware-ve dhe update-imin e software-ve, por edhe per mirembajtjen dhe administrimin e database-it te programit Anti-money Laundering (sistemi i raportimit elektronik) qe eshte instaluar kohet e fundit ne kete Drejtori..

### **Projekti CARDS 2004**

Ky projekt parashikon:

- pajisjen e DPPPP me hardware te sofistikuara qe te mundesojne zbatimin e projektit IT
- krijimin e nje rrjeti te brendshem intranet
- rrjet i jashtem komunikimi me institucionet partnere dhe subjektet raportuese te parashikuara nga ligji.

Projekti CARDS 2004 ka nje kohezgjatje per rreth dy vjet, periudhe gjate se ciles do te mundesohet nga BE jo vetem zbatimi i projektit IT, por edhe asistenca teknike per rreth tre vjet pas perfundimit te tij.

Bashkepunimi i frutshem ndermjet DPPPP dhe subjekteve raportuese, sidomos bankave te nivelit te dyte, ka bere qe niveli i raportimit (RTV+RAD) kohet e fundit te rritet se tepermi. Ky raportim, qe nga data e fillimit te tij ne vitin 2001, eshte kryer totalisht ne hard copy, gje qe ka krijuar mjaft veshtiresi ne regjistrimin e sakte te te dhenave dhe analizimin e tyre ne menyre eficente.

Programi “Anti-Money Laundering” u dizenjua sipas modeleve te RTV e RAD te percaktuara nga ligji per Pastrimin e Parave.

Programi AML eshte prone e DPPPP dhe u ofrohet per perdorim, pa pagese, te gjitha Subjekteve Raportuese.

## **11. Objektivat kryesore te punes per vitin 2007 te Drejtorise se Pergjithshme te Parandalimit te Pastrimit te Parave**

Gjate vitit 2007 Drejtoria e Pergjithshme e Parandalimit te Pastrimit te Parave synon te realizoje nje sere objektivash te rendesishem, duke perfshire ketu edhe permbushjen e atyre objektivave te mbetura te paplotesuara gjate vitit 2006, apo perfundimin e punes nisur po gjate vitit 2006 per realizimindisa objektivave te percaktuar ne planin vjetor 2006. Keshtu, konkretisht permendim:

### **11.1 Inspektive**

- ne Organet Tatimore,
- ne Agjensine Kombetare te Privatizimit,
- ne Kompanite e Sigurimeve,
- ne Organet Doganore, ne Zyrat e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme dhe ZQRPP(ne kuader te perfshirjes ne draft-ligjin e ri te ketyre subjekteve si subjekte raportuese prane Autoritetit Pergjegjes),
- ne Zyrat e Kembimeve Valutore,
- ne Agjensite e Udhetimit,
- ne Lojrat e Fatit dhe Kazinote,
- ne Bankat e nivelit te dyte(ne vazhdimesi te bashkepunimit me Banken e Shqiperise per inspektimin dypalesh ne keto subjekte te ligjit),
- tek Noteret dhe tek Avokatet (ne kuader te perfshirjes ne draft-ligjin e ri te ketyre subjekteve si subjekte raportuese prane Autoritetit Pergjegjes),

me qellim verifikimin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në ligjin nr. 8610, date 17. 05. 2000 “ Për parandalimin e pastrimit të parave “ , te ndryshuar, ligjit nr.9258, date 15.07.2004 ”Per masat kunder financimit te terrorizmit” si dhe aktet nenligjore te nxjera ne zbatim te tyre. Ne rastet e mosrespektimit te detyrimeve ligjore marrja e masave konkrete. Ky objektiv do te realizohet nga Specialistet e Drejtorise se Inspektimit

### **11.2 Identifikimi, verifikimi dhe analiza e informacionit financiar (i marre me ane te raportimeve nga subjektet e parashikuara ne ligj , nga institucionet e tjera partnere apo nga njesite homologe neper bote)**

- Analiza e rasteve qe do te vijne gjate 2007 si dhe atyre te mbartura nga viti 2006 te cilat kane tregues te dyshimte per pastrim parash dhe financim terrorizmi,
- Analiza e Raporteve te Transaksioneve te vlerave(RTV)

me qellim intensifikimin dhe thellimin e analizës për çdo rast, rritjen e rasteve për referim në DPT, PP, dhe MB si dhe intensifikimin e bashkëpunimit me institucionet partnere shqiptare apo të huaja

**11.3 Forcimi i bashkëpunimit nder-institucional me strukturat brenda vendit dhe rritjes së bashkëpunimit me subjektet raportuese dhe agjensite e zbatimit të ligjit** (nëpërmjet shkëmbimit të informacionit në mënyrë sa më të shpejtë, korrekte dhe me efikasitet) do të vazhdojë puna për:

- Mbledhjen çdo muaj e Grupit Teknik të Punës (Grupi i bashkëpunimit nder-institucional)
- Ndjekjen e zbatimit të programit kombëtar për eliminimin e Cash-it në kufi në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, DPT, DPD dhe institucione të tjera të interesit
- Ndjekjen në vazhdimësi të rasteve të kalëzuara në Prokurori, Minsitri të Brendshme, DPT, DPD, etj
- Shkëmbimin e vazhdueshëm të informacionit me të gjitha institucionet partnere të interesit për të përgatitur raste sa më qarta e të plota për t'ia paraqitur agjensive të zbatimit të ligjit për të marrë masat e nevojshme
- Vazhdimësinë e programit dy-palësh të inspektimeve në bankat e nivelit të dytë me Bankën e Shqipërisë, si dhe fillimin e një programi dy-palësh inspektimesh me DPD për Njesitë Qendrore pranë pikave doganore

**11.4 Shtrirja e programit AML në 12 bankat e nivelit të dytë**

- instalimi dhe testimi i programit në qendër dhe në deget e tyre, raportimi vetëm në formë elektronike
- marrja e raporteve në format elektronik

**11.5 Bashkëpunimi me Njesitë homologe dhe institucionet e tjera partnere**

- përpjekje për nënshkrimin e MoU me njesitë homologe të huaja, legjislativi i të cilave e lejon një hap të tillë (për nënshkrimin e ketyre MoU do të merren parasysh nevojat për bashkëpunim në shkëmbimin e informacionit të Drejtorisë së Analizës). Vendet me të cilat parashikohet të nënshkrohen MoU janë:

- ✓ Italia,
- ✓ Greqia,
- ✓ Australia,
- ✓ Izraeli,
- ✓ Paraguaj,

- ✓ Polonia,
- ✓ Turqia,
- ✓ Emiratet e Bashkuara Arabe.

- rikonceptimi dhe nenshkrimi i marreveshjeve nderinstitucionale me institucionet e zbatimit te ligjit, pas hyrjes ne fuqi te ligjit te ri per PP(dhe akteve nënligjore në zbatim të tij) duke pergatitur e draftet ligjore sipas parashikimeve te ligjit te ri te pastrimit te parave, per te gjitha subjektet dhe organet shteterore te zbatimit te ligjit
- nenshkrimi i MoU me Departamentin e Antikorrupsionit ne Keshillin e Ministrave
- nenshkrimi i MoU me ALUIZNI